

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

---

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare  
për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2010

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQET</b>
Raporti i auditorit të pavarur	2
Pasqyrat Financiare	
Gjendja e Bilancit	3
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parave	6
Shënimet për pasqyra financiare	7 - 17



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Bordit të Drejtorëve të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC-së, të cilat përfshijnë bilancin e gjendjes më 31 Dhjetor 2010, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parave për vitin që u mbyll, dhe shënimet tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me rrethanat.

#### *Përgjegjësia e auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim të marrjes së provave të auditimi për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin ato rezultat i mashtrimeve apo pasaktësive. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë bazë të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të ATRC-së më 31 dhjetor 2010, dhe rezultatin e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara në Republikën e Kosovës.

**Armen Osaj** Auditor ligjor  
ACA – Audit & Consulting Associates  
Prishtinë, Kosovë  
Mars 2011



## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Bilanci i gjendjes

Deri më 31 Dhjetor

	Shënim	2010	2009
<b>Asetet</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj	4	31,160	76,160
Llogarite e arketueshme	5	4,962	-
Avanse për grantmarrësit	6	250	12,269
<b>Totali i aseteve aktuale</b>		<b>36,372</b>	<b>88,429</b>
Prona dhe pajisjet	7	12,972	18,159
Asetet e patrupëzuara	8	-	348
<b>Totali i aseteve joaktuale</b>		<b>12,972</b>	<b>18,507</b>
<b>Totali aseteve</b>		<b>49,344</b>	<b>106,936</b>
<b>Detyrimet dhe fondi i bilancit</b>			
Të ardhurat e shtyera	9	8,320	68,936
Të pagueshmet	10	11,794	1,024
<b>Totali i detyrimeve aktuale</b>		<b>20,113</b>	<b>69,960</b>
<b>Fondi i bilancit</b>		<b>29,231</b>	<b>36,976</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe fondi i bilancit</b>		<b>49,344</b>	<b>106,936</b>

Deklaratat financiare të paraqitura në faqet 3-17 ishin të autorizuar për çështje nga menaxhimi më 28 Mars 2011 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



**Kushtrim Kaloshi**  
Drejtor Ekzekutiv



**Gani Asllani**  
Menaxher Financiar dhe  
Administrativ

Shënimet në faqet 7 deri 17 janë pjesë përbërëse të këtyre deklaratave financiare.

## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor

	<b>Shënim</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
Të ardhurat nga grantet	<b>11</b>	339,306	174,091
Të ardhura tjera	<b>12</b>	28,338	35,467
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>367,643</b>	<b>209,558</b>
Programi i shpenzimeve	<b>13</b>	(360,245)	(194,635)
Shpenzimet administrative	<b>14</b>	(15,143)	(11,738)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(375,388)</b>	<b>(206,372)</b>
<b>Neto (deficiti) / bilanci pozitiv për vitin</b>		<b>(7,745)</b>	<b>3,186</b>

Shënimet në faqet 7 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre deklaratave financiare.

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010

	<b>EUR</b>
<b>Bilanci më 1 Janar 2009</b>	33,790
Teprica për vitin	3,186
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>36,976</b>
Bilanci më 1 Janar 2010	36,976
Deficiti për vitin	(7,745)
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>29,231</b>

Shënimet në faqet 7 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre deklaratave financiare.

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Pasqyra e rrjedhës së parave

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor

	2010	2000
<b>Rrjedha e parasë se gatshme nga aktivitetet operative</b>		
(Mungesa)/teprica për vitin	(7,745)	3,186
Përshtatja për:		
Zhvlerësimi	5,657	5,562
Amortizimi	348	348
Ndryshimet në avanse	12,019	(9,269)
Ndryshimet në të arkëtueshme	(4,962)	-
Ndryshimet në të pagueshmet	10,769	728
Ndryshimi në të ardhurat e shtyera	(60,617)	66,959
<b>Neto paratë e gatshme nga aktivitetet operative</b>	<b>(44,530)</b>	<b>67,514</b>
<b>Rrjedha e parave nga aktivitetet e investimeve</b>		
Blerja e pronave dhe pajisjeve	(470)	(1,993)
<b>Neto paratë e gatshme të përdorura për aktivitetet investuese</b>	<b>(470)</b>	<b>(1,993)</b>
<b>Neto rritja në para të gatshme dhe ekuivalentet e saj</b>	<b>(45,000)</b>	<b>65,521</b>
Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar	76,160	10,638
<b>Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 Dhjetor</b>	<b>31,160</b>	<b>76,160</b>

Shënimet në faqet 7 deri 17 janë pjesë përbërëse të këtyre deklaratave financiare.

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

### 1. Gjenerale

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (më tutje "Organizata" ose "ATRC"), është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar në pajtim me Rregulloren Nr. 1999/22 të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara Misioni në Kosovë, dhe më pastaj në pajtim me ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, aprovuar nga parlamenti i Kosovës në 2009, me numër regjistrimi 5200095-5 që nga 11 Qershori 2003, PBS 6001014-5 si dhe me numër fiscal 600254594.

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), është e fokusuar në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe për stabilitet rajonal.

ATRC-ja punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativa qytetare, administratë publike, institucione politike dhe media pa dallim feje, përkatësie politike, etnie, moshe, gjinie, aftësie dhe orientim seksual.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programet kryesore: Administrimi i Granteve, Avokimi, Ngritja e Kapaciteteve, si dhe këmbimi i informatave në Kosovë dhe jashtë saj. Që nga themelimi i saj në 2001, ATRC-ja ka ndihmuar OJQ të shumta në Kosovë për të profesionalizuar punën e tyre, artikuluar kërkesat e tyre, dhe avokuar në struktura qeveritare për çështjet që kane ndikim në shoqërinë e Kosovës.

ATRC-ja është e njohur për ofrimin e një platforme për diskutim mbi çështjet më të ndieshme që kanë të bëjnë me shoqërinë civile dhe qytetarët e zakonshëm përmes organizimit të debateve publike. ATRC-ja ka hartuar dhe zbatuar më shumë se 100 trueza të rrumbullakëta dhe diskutime publike, ka marrë pjesë në reforma të mëdha zgjedhore, ka organizuar një numër të fushatave për avokim, si dhe një numër të konsiderueshëm të "Town Hall" takimeve për çështje të ndryshme, siç janë: zgjedhjet, legalizimin e ndërtimeve pa leje, regjistrimit të popullsisë etj.

Donatorët dhe përkrahësit e ATRC-së janë:

1. Agjensioni i SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
2. Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (K-CSSP)
3. Qeveria Holandeze - Ambasadorët e Mjedisit (ARM)
4. AED – Programi i iniciativave për ndryshime pozitive - Kosovë
5. Qendra Ndërkombëtare Olof Palme (OPIC)
6. Ambasada Amerikane - Prishtinë
7. Komisioneri i Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR)
8. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

### 2. Bazat e prezantimit dhe përmbledhjet e politikave të rëndësishme të kontabilitetit

#### a) Deklarata e pajtueshmërisë

Deklaratat shoqëruese financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës (“SKA”).

#### b) Valuta funksionale dhe prezantuese

Deklaratat financiare janë të prezantuara në Euro (“EUR”), valutë lokale në Kosovë. Të ardhurat janë pranuar në EUR dhe në US Dollarë (“USD”), shpenzimet janë bërë vetëm në EUR. Euro është valutë matëse e Organizatës pasi që ajo reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve themelore dhe rrethanat e Organizatës.

#### c) Avanset për grantmarrësit

Avanset për grantmarrësit janë fonde të marrura nga Organizata për grantmarrësit të lidhura me projektet që duhet të implementohen në 2011. Avanset maten me kosto.

#### d) Asetet Fikse

Asetet fikse janë paraqitur në koston e tyre historike të zhvlerësimit të akumuluar, e cila është llogaritur në baza të vijës së drejtë mbi jetëgjatësinë e tyre të vlerësuar. Normat vjetore të amortizimit janë si vijojnë:

	<i>In %</i>
Pajisjet Kompjuterike	20
Pajisjet e Zyreve	20
Veturat	16.66

#### e) Detyrimet

Detyrimet barten në kosto.

#### f) Të hyrat

Fondet e donatorëve janë të njohura si të ardhura të shtyera kur pranohen. Më pas, kur projektet implementohen fondet njihen si të ardhura.

#### g) Transakcionet me valutë të huaj

Transakcionet me valutë të huaj janë kthyer në EUR në kursin e këmbimit të vendit në datën e transakcionit. Asetet monetare dhe detyrimet e emërtuara në valuta të huaja në datën e gjendjes së bilancit janë të kthyera në EUR në kursin e këmbimit të jashtëm në atë datë. Ndryshimet e jashtme të këmbimit që duken në kthim janë të njohura në deklaratën e aktiviteteve. Asetet jomonetare dhe detyrimet e denominuara në këmbimin e huaj, të cilat janë paraqitur me kostot historike, janë të kthyera në ratën e këmbimit të huaj në datën e transakcionit.

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

### 3. Tatimi

Organizata ATRC është e regjistruar si organizatë jo-profitabile nën rregulloret e UNMIK-ut, prandaj është e përjashtuar nga tatimi mbi korporata mbi të hyrat dhe fitimet e gjeneruara.

### 4. Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj përbëhen nga:

	31 Dhjetor 10	31 Dhjetor 09
Paratë e gatshme në dorë	218	233
Paratë e gatshme në bankë	30,942	75,927
<b>Totali i parave të gatshme dhe ekuivalentet e saj</b>	<b>31,160</b>	<b>76,160</b>

Organizata mbanë të gjitha llogaritë e saj bankare në Pro Credit Bank të Kosovës, të cilat janë të ndara në llogari sipas donatorëve.

### 5. Llogaritë e arkëtueshme

	31 Dhjetor 10	31 Dhjetor 09
Fondet nga REA	4,582	-
Fondet nga ISC	380	-
<b>Totali i llogarive të arkëtueshme</b>	<b>4,962</b>	<b>-</b>

Llogaritë e arkëtueshme paraqesin shërbimet e ofruara nga ATRC gjatë vitit 2010, mirëpo pagesat do të realizohen gjatë vitit 2011.

### 6. Avanset për grantmarrësit

Avanset për grantmarrësit janë të përbëra nga:

	31 Dhjetor 10	31 Dhjetor 09
Avanset për grantmarrësit e KCSP-së	-	12,140
Avanset tjera	250	129
<b>Totali i avanseve të grantmarrësve</b>	<b>250</b>	<b>12,269</b>

Avanset e grantmarrësve në KCSP për vitin 2010 i referohen avanseve që u jipen 5 OJQ-ve (Fortesa, SHVPDK, Liria, Handicap dhe BCS).

## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

#### 7. Prona dhe pajisjet

Asetet Fikse të Organizatës përbëhen nga kompjuterët, pajisjet e zyreve dhe veturat.

	Kompjuterët	Pajisjet e zyrës	Veturat	Totali
<b><i>Kostoja</i></b>				
Më 1 Janar 2009	20,837	16,778	41,392	79,007
Shtojcat	1,589	-	403	1,992
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>22,426</b>	<b>16,778</b>	<b>41,795</b>	<b>80,999</b>
Më 1 Janar 2010	22,426	16,778	41,795	80,999
Shtojcat	470	-	-	470
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>22,896</b>	<b>16,778</b>	<b>41,795</b>	<b>81,469</b>
<b><i>Zhvlerësimi i akumuluar</i></b>				
Më 1 Janar 2009	12,248	11,967	33,062	57,277
Detyrimi i zhvlerësimit për vitin	2,917	979	1,667	5,562
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>15,165</b>	<b>12,946</b>	<b>34,729</b>	<b>62,840</b>
Më 1 Janar 2010	15,165	12,946	34,729	62,840
Detyrimi i zhvlerësimit për vitin	3,011	979	1,667	5,567
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>18,176</b>	<b>13,925</b>	<b>36,395</b>	<b>68,486</b>
<b><i>Shuma e bartur</i></b>				
<b>Më 1 Janar 2009</b>	<b>8,589</b>	<b>4,811</b>	<b>8,330</b>	<b>21,730</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>7,261</b>	<b>3,832</b>	<b>7,066</b>	<b>18,159</b>
<b>Më 1 Janar 2010</b>	<b>7,261</b>	<b>3,832</b>	<b>7,066</b>	<b>18,159</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>4,720</b>	<b>2,853</b>	<b>5,400</b>	<b>12,973</b>

## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

#### 8. Asetet e patrupëzuara

	Softueri	Totali
<i><b>Kostoja</b></i>		
Më 1 Janar 2009	1,739	1,739
Shtojcat	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>1,739</b>	<b>1,739</b>
Më 1 Janar 2010	1,739	1,739
Shtojcat	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>1,739</b>	<b>1,739</b>
<i><b>Amortizimi i akumuluar</b></i>		
Më 1 Janar 2009	1,043	1,043
Detyrimi për vitin	348	348
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>1,391</b>	<b>1,391</b>
Më 1 Janar 2010	1,391	1,391
Detyrimi për vitin	348	348
<b>Më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>1,739</b>	<b>1,739</b>
<i><b>Shuma e bartur</b></i>		
<b>Më 1 Janar 2009</b>	<b>696</b>	<b>696</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>348</b>	<b>348</b>
<b>Më 1 Janar 2010</b>	<b>348</b>	<b>348</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

### 9. Të hyrat e shtyera

Të ardhurat e shtyera më 31 Dhjetor 2010 paraqesin fondet e pashpenzuara të dhëna në 2010 nga Organizatat e përmendura më poshtë. Sipas marrëveshjeve ndërmjet ATRC-së dhe donatorëve, fondet e pashpenzuara në vitin 2010 do të përdoren gjatë vitit 2011 për aktivitetet e programit.

EUR	ISC Granti	REA Granti	Ambasada e SHBA në Prishtinë Fondi	BTD Fondet	Totali
Bilanci në 31 Dhjetor 2009	16,563	39,366	13,007	-	68,936
Shtesat në 2010	91,252	44,979	39,395	23,476	199,102
Të hyrat e njohuru në 2010	(107,815)	(84,345)	(52,403)	(15,156)	(256,719)
<b>Bilanci në 31 Dhjetor 2010</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>8,320</b>	<b>8,320</b>

### 10. Të pagueshmet

Të pagueshmet kanë të bëjnë me tatimet për paga dhe qira, shpenzimet e auditimit, pagesa e fundit prej 10% për 5 OJQ, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shërbimeve që kanë ndodhur në vitin 2010, e të cilat janë paguar në vitin 2011.

### 11. Të ardhurat nga grantet

Të ardhurat nga grantet për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 janë të përbëra nga:

Të hyrat kryesore	2010	2009
Fondet e UNHCR-së	55,838	55,519
Ambasada e Britanisë në Prishtinë	-	7,737
Qendra Ndërkombëtare e Olof Palme (OPIC)	38,905	36,516
Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë	52,403	4,597
Fondet e CSSP	-	3,760
Instituti për komunitet të Qëndrueshëm (Fondet e ISC-)	107,815	26,992
Ambasadorët e Mjedisit (Fondet REA)	84,345	36,994
Fondet e BTD	-	1,977
<b>Totali</b>	<b>339,306</b>	<b>174,091</b>

## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

#### 12. Të ardhurat tjera

Të ardhurat tjera për vitin e përfunduar 31 Dhjetor 2010 paraqesin të ardhurat e gjeneruara nga ATRC. Të ardhurat tjera përbëhen si në vijim:

	2010	2009
Të ardhurat e Programit	15,156	3,596
AED	13,181	-
MBZHRDP	-	8,444
UNDP	-	8,953
Rjeti Euklid	-	13,564
Fondet IC-MP	-	460
MVPT	-	450
<b>Totali</b>	<b>28,338</b>	<b>35,467</b>

#### 13. Shpenzimet e Programit

Shpenzimet e programit janë të gjitha shpenzimet e bëra nga Organizata për implementimin e projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm. Organizata i mbanë të dhënat e shpenzimeve, për çdo donator përkatësisht sipas vijës buxhetore të miratuar nga donatori. Të gjitha fondet që janë pranuar janë përdorur për shpenzimet e programit përveq fondeve të pranuar nga KCSP-ja të cilat janë ndarë në shpenzime të programit dhe ato administrative.

Shpenzimet e Programit	2010	2009
Grantet	79,090	5,799
Personeli	119,330	102,347
Trajnimet	127,544	57,840
Qiraja, shërbimet dhe mirëmbajtja	29,658	24,421
Udhëtimet dhe veturat	2,247	2,599
Furnizimet dhe postimi	1,556	1,441
Kompjuterat dhe shpenzimet e zyreve	-	188
<b>Totali i shpenzimeve të programit</b>	<b>360,245</b>	<b>194,635</b>

## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

#### 13. Shpenzimet e programit (vazhdimi)

Ndarja e shpenzimeve të programit për nga kategoria dhe burimi i financimit në 2010 mund të jetë i detajuar si në vijim:

BUDGET LINE ITEMS	EXPENSES ISC/ Grants	EXPENSES UNHCR	EXPENSES OPIC	EXPENSES SIC-SIF- VO	EXPENSES REA	EXPENSES SIC-SIF- 12	EXPENSES A. Amerikane	EXPENSES AED	EXPENSES ATRC	Total EXPENSES
PERSONNEL	17,651.61	47,348.17	9,977.85	924.53	18,022.81	638.78	18,045.84	6,720.27	7,279.26	126,609.12
TRAVEL & VEHICLE	2,134.22					113.18				2,247.40
SUPPLIES & POSTAGE	690.80	715.54				149.58				1,555.92
RENT, UTILITIES, COMUNIC& MAINTENANCE	3,484.81	7,748.79	5,278.21		2,813.78	90.78	3,572.29	1,161.33	5,508.06	29,658.05
TRAINING/ PROJECT EXPENSE & PUBLICATIONS	326.14		23,649.09		63,508.84	2,791.66	30,784.40	5,299.65	1,184.29	127,544.07
AUDIT 2010									1,740.00	1,740.00
GRANTS	79,909.34									79,909.34
DEPRECIATION									6,004.68	6,004.68
BANK CHARGES	79.45	25.50		6.00		14.50				125.45
<b>TOTAL EXPENSES</b>	<b>104,276.37</b>	<b>55,838.00</b>	<b>38,905.15</b>	<b>930.53</b>	<b>84,345.43</b>	<b>3,798.48</b>	<b>52,402.53</b>	<b>13,181.25</b>	<b>21,716.29</b>	<b>375,394.03</b>

Ndarja e shpenzimeve të programit për nga kategoria dhe burimi i financimit në 2009 mund të jetë i detajuar si në vijim:

BUDGET LINE ITEMS	EXPENSES ISC/ Grants/ SIC-SIF	EXPENSES UNHCR	EXPENSES OPIC	EXPENSE S British Embassy.	EXPENSES REA	EXPENSES UNDP	EXPENSES A. Amerikane	EXPENSES EUCLID	EXPENSES MBPZHRDP	EXPENSES ATRC	Total EXPENSES
PERSONNEL	15,040.95	46,267.20	9,370.80	1,260.00	15,000.00	8,743.92	4,503.22		2,160.90	4,227.66	106,574.65
TRAVEL & VEHICLE	1,309.29					209.08			1,080.45		2,598.82
COMPUTER & OFFICE EQUIPMENT		187.60									187.60
SUPPLIES & POSTAGE	185.85	1,116.33						138.74			1,440.92
RENT, UTILITIES, COMUNIC& MAINTENANCE	2,330.00	7,862.12	5,738.39	1,712.93	2,741.21			1,080.45		2,956.14	24,421.24
TRAINING/ PROJECT EXPENSE	2,076.60		21,305.99	2,090.14	19,042.71		74.50	9,102.59	4,122.05	25.80	57,840.38
AUDIT										1,000.00	1,000.00
GRANTS	5,798.63										5,798.63
DEPRECIATION										5,910.14	5,910.14
BANK CHARGES	49.50	15.50	94.53	14.00	209.72		19.00	33.13		164.50	599.88
<b>TOTAL EXPENSES</b>	<b>26,790.82</b>	<b>55,448.75</b>	<b>36,509.71</b>	<b>5,077.07</b>	<b>36,993.64</b>	<b>8,953.00</b>	<b>4,596.72</b>	<b>9,274.46</b>	<b>8,443.85</b>	<b>14,284.24</b>	<b>206,372.26</b>

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

### 14. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative kryesisht janë të financuara na KCSP dhe Organizata.

	2010	2009
Personeli	7,279	4,228
Auditimi	1,740	1,000
Zhvlerësimi	6,005	5,910
Detyrimet e bankës	119	600
<b>Totali</b>	<b>15,143</b>	<b>11,738</b>

Numri i të punësuarve të organizatës deri më 31 Dhjetor 2010 ishte 17 të rregullt dhe 53 të kontraktuar.

### 15. Instrumenti Financiar

#### (i) Rreziku i kredisë

Instrumentet financiare, që potencialisht subjektojnë organizatën në përqendrimet e rrezikut të kredisë, kryesisht përbëhet nga të hyrat dhe avanset dhënë OJQ-së. Të hyrat dhe avanset e rrezikut të kredisë së OJQ-së kontrollohen përmes miratimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore që gjenerojnë të hyrat e tilla.

#### (ii) Rreziku i valutës së huaj

Organizata i është ekspozuar rrezikut të valutës së huaj pasi që fondet përveç se në EUR gjithashtu janë pranuar edhe në USD. Fondet e pranuar në USD janë përkthyer në EUR, dhe janë shpenzuar vetëm në EUR.

#### (iii) Vlera e drejtë

Organizata ka asetet financiare, që përfshijnë të pranueshmet (avanset e grantmarrësve) dhe paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj. Organizata ka detyrime financiare, të cilat përfshijnë të pagueshmet dhe të ardhurat e shtyera. Vlera e drejtë e këtyre instrumenteve financiare nuk është materialisht e ndryshme nga vlera e tyre e caktuara për shkak të pjekurië së tyre të shkurtër dhe përafrimi i parave të gatshme.

*Tregu dhe të pranueshmet tjera / të pagueshmet*

Të gjitha të pranueshmet /te pagueshmet e grupit kanë një jetë të mbetur më pak se një vit, shuma e paramenduar reflekton vlerën e drejtë.

## Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

### Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

#### 15. Instrumenti Financiar (vazhdimi)

##### (iv) *Rreziku i normës së interesit*

Të ardhurat e Organizatës dhe rrjedha e parave në thelb janë të pavarura nga ndryshimet në tregun e normave të interesit. Nuk ka huazim me baza interesi.

##### (v) *Rreziku i likuditetit*

Më poshtë janë maturitetet kontraktuale të detyrimeve financiare duke përjashtuar ndikimin marrëveshjeve të rrjetizimit:

	2010	2009
	Pagesa pritët të bëhet brenda 1-12 muajve	Pagesa pritët të bëhet brenda 1-12 muajve
	EUR	EUR
Të pagueshmet	11,794	1,024
<b>Totali</b>	<b>11,794</b>	<b>1,024</b>

#### 16. Palët e ndërlidhura

Pala e ndërlidhur është çdo palë që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose për të ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Palët e ndërlidhura përfshijnë donatorin kryesorë UNHCR, Institutin për Komunitete të Qëndrueshme (Fondet e ISC-së), anëtarët e Bordit dhe zyrtarët ekzekutiv të Organizatës.

Përmbledhja e transaksioneve të palëve të ndërlidhura për vitin 2010 dhe 31 Dhjetorit 2009 janë si vijojnë:

	2010	2009
<b><i>Transaksionet me donatorin kryesorë</i></b>		
Fondet e pranuar nga IREX (KCSP)	55,838	55,448
Fondet e pranuar nga Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Fondet e ISC-së)	93,297	43,555
<b><i>Transaksionet me Bordin</i></b>		
Shpenzimet e rrogave të anëtarëve të Bordit	-	-
<b><i>Transaksionet me menaxhmentin</i></b>		
Shpenzimet e rrogës së Drejtorit Ekzekutiv	18,300	14,733
Shpenzimet e rrogës së Menaxherit Financiar	16,538	10,400
Kostot e udhëtimit dhe akomodimit	-	-

# Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

## Shënimet për pasqyrat financiare më 31 Dhjetor

### **17. Angazhimet dhe paparashikimet**

Nuk ka angazhime dhe paparashikime të njohura për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009: nuk ka).

### **18. Ngjarjet pas datës së gjendjes së bilancit**

Menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së gjendjes së bilancit që mund të ketë ndonjë efekt ose që kërkon vëmendje në deklaratat financiare të Organizatës më 31 Dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009: nuk ka).